



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi b) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Studio Hapsira" Sh.P.K. të datës 19.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 14.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime konsulente multidisiplinare për të përgatitur dizajnin dhe mbikëqyrur ndërtimin e një kolegji të ri për artet pamore dhe performancës në Prishtinë" me nr. të prokurimit 616-22-7292-3-1-2 dhe me nr. të brendshëm 616 22 102 312, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Studio Hapsira" Sh.P.K. e datës 19.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 14.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime konsulente multidisiplinare për të përgatitur dizajnin dhe mbikëqyrur ndërtimin e një kolegji të ri për artet pamore dhe performancës në Prishtinë" me nr. të prokurimit 616-22-7292-3-1-2 dhe me nr. të brendshëm 616 22 102 312.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Studio Hapsira" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Studio Hapsira" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 20.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 14.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime konsulente multidisiplinare për të përgatitur dizajnin dhe mbikëqyrur ndërtimin e një kolegji të ri për artet pamore dhe performancës në Prishtinë" me nr. të prokurimit 616-22-7292-3-1-2 dhe me nr. të brendshëm 616 22 102 312.

Faqe 1 nga 4

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

**Pretendimi i parashtruesit është cituar si në vijim:** *"Me datë 14.04.2023 autoriteti kontraktues ka njoftuar për eliminimin tonë me arsyetimin se mungon sigurimi i tenderit. Ne sigurimin e tenderit e kemi futur në zarfën e ofertës financiare e cila gjithashtu është pjesë përbërëse e dosjes së tenderit prandaj ne nuk pajtohemi me vendimin e autoritetit kontraktues".*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 27.03.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimit të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- Njoftimi për kontratë i dt. 19.07.2022;
- Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara i dt. 10.01.2023;
- Formulari standard për korigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara i dt. 20.01.2023;
- Dokumenti standard i parakualifikimit i dt. 19.07.2022;
- Njoftimi mbi vendimin e AK - kandidatët e kualifikuar për fazën II i dt. 29.11.2022;
- Dosja e tenderit e dt. 30.12.2022;
- Oferta e dorëzuar nga parashtruesi;
- Raporti i vlerësimit të tenderëve, Propozimi teknike - Faza e dytë, i dt. 21.03.2023;
- Procesverbali i hapjes së tenderëve 12.02.2023;
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 14.04.2023;

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruesit në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafi d) të Rregullores (A01) nr.001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP").

**Sa i përket pretendimit të parashtruesit fillimisht duhet cekur se në këtë rast kemi të bëjmë me një procedurë të prokurimit për shërbime të konsulencës e cila zhvillohet si procedurë e kufizuar me dy faza. Përmes nenit 31 paragrafit 31.1 të RRPP përcaktohet se " për shërbimet e konsulencës aplikohet dorëzimi fizik i tenderëve përmes dy zarfave". Ndërsa përmes nenit 46 paragrafit 46.3 përcaktohet se "Qasja me dy zarfe nënkupton se Operatorët ekonomik dorëzojnë dy zarfe të mbyllura në të njëjtën kohë, njëra përmban Propozimin Teknik dhe tjetra përmban Propozimin Financiar të dyja të futura në nja zarf të vetëm të jashtëm. Qasja me dy zarfe aplikohet vetëm kur përdoret një procedurë e kufizuar, për shërbime konsulente".**

Tutje përmes nenit 46 paragrafit 46.5 përcaktohet në mënyrë konkrete se “Propozimi Financiar do të përmbajë vetëm informatat që kanë të bëjnë me çmimin bazuar në shtrirjen e specifikacioneve dhe kërkesave të projektit”. Kjo nënkupton që në zarfin ku dorëzohet propozimi financiar duhet të përfshihen vetëm ato informata që kanë të bëjnë me çmimin e ofertës së tenderuesit dhe asgjë tjetër. Fjala vetëm që potencohet në këtë dispozitë do të thotë që të gjitha dokumentet tjera përveç çmimit dorëzohen me propozimin teknik (pikërisht për këtë arsye logjike kjo procedurë zhvillohet edhe me dy faza, në të kundërtën do të ishte zhvilluar vetëm me një zarf). Në rastin konkret, kuptohet se sigurimi i tenderit nuk ka asnjë ndërlidhje me çmimin e ofertës me të cilin oferton një tenderues.

Pra ky dokument (sigurimi i tenderit) duhet të dorëzohet me propozimin teknik sipas nenit 46 të RRPP dhe për këtë çështje parimisht nuk do të duhej të kishte as dilemë sepse RRPP është shumë e qartë në këtë pikë. Përkundër këtij fakti, nëse analizohet pretendimi i parashtruesit, aty thuhet se “*Ne sigurimin e tenderit e kemi futur në zarfin e ofertës financiare*”! Pra edhe nëse nisemi nga supozimi se ky konstatim i parashtruesit është i vërtetë, atëherë do të gjejmë se veprimi i parashtruesit me rastin e dorëzimit të ofertës është në kundërshtim të plotë me nenin 46 të RRPP (sikurse u citua më sipër). Me fjalë të tjera sigurimi i tenderit si kriter i përcaktuar me dosjen e tenderit për fazën e dytë të kësaj procedure të kufizuar, sipas këtij neni të RRPP nuk duhet të dorëzohet së bashku me zarfin e ofertës financiare siç pretendohet të jetë vepruar nga parashtruesi në këtë rast.

Sipas nenit 46 paragrafit 46.6 të RRPP përcaktohet se “*Vetëm propozimet teknike hapen në datën dhe kohën e specifikuar në Dosjen e Tenderit dhe propozimi financiar mbetet i mbyllur dhe mbahet në ruajtje nga Zyrtari i Prokurimit deri në kohën e hapjes së Propozimeve Financiare. Përparësia është se vlerësimi lidhur me pranueshmërinë dhe kualifikimet nuk do të ndikohen nga çmimi i tenderuesve. Zarfet që përmbajnë pjesën financiare të tenderit nuk mund të hapen deri në përfundim të vlerësimeve teknike dhe radhitjes së tenderëve dhe tenderuesit e radhitur të jenë njoftuar për kohën dhe vendin e hapjes duke i informuar ata për të drejtën e tyre për të qenë prezent në takim*”. Kjo nënkupton që fakti nëse parashtruesi me të vërtetë e ka dorëzuar ose jo sigurimin e tenderit përmes zarfit të ofertës financiare, është tërësisht jorelevant për rastin. Kjo pasi që zarfi i ofertës financiare edhe ashtu nuk është e lejuar që të hapet në këtë fazë.

Kujtojmë se në këtë fazë komisioni vlerësues me datë 21.03.2023 ka dorëzuar raportin e vlerësimit të tenderëve vetëm sa i përket propozimit teknik (në kuadër të fazës së dytë të procedurës së kufizuar të prokurimit). Prandaj në asnjë formë nuk është as e mundur dhe as e lejuar që të hapen zarfat me propozimet financiare të tenderuesve. Për më tepër sipas nenit 46 paragrafit 46.9 të RRPP përcaktohet se “*Autoriteti Kontraktues do t’i njoftojë Tenderuesit me shkrim të cilët janë refuzuar në bazë të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe do t’iu kthejë Propozimet Financiare pa i hapur*”. Nga kjo mund të konstatohet se as për vet parashtruesin nuk është kontestues fakti që sigurimi i tenderit nuk është dorëzuar ose të paktën nuk është dorëzuar në mënyrën e përcaktuar sipas nenit 46 të RRPP.

Patjetër duhet marrë parasysh edhe nenin 10 përkatësisht faqen nr. 41 të Udhëuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik ku përcaktohet që nëse “*Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e DT - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm*”. Prandaj komisioni vlerësues me të drejtë ka rekomanduar refuzimin e tenderit për shkak të mungesës së sigurimit të tenderit nga parashtruesi. Në këtë mënyrë është gjetur se edhe pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 27.04.2023**

**Visar SHEHU**

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.